

VENDIM
Nr.536, datë 4.8.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE
TË ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT I KALOJNË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, DEGA E
TATIM-TAKSAVE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të kateve, të pestë dhe të gjashtë, me sipërfaqe të përgjithshme 2 400 m², të ndërtesës së Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dega e tatim-taksave, Tiranë.

2. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha